

KUSHTET E PËRGJITHSHME

OBJEKTI I SIGURIMIT

Objekt i kësaj kontrate është sigurimi i përgjegjësisë të drejtuesit të mjetit motorik, i cili hyn në territorin e Republikës së Shqipërisë me një mjet me regjistrim të huaj, për dëmet që ky drejtues mund t'i shkaktojë palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti, si rrjedhojë e veprimeve ose mosveprimeve të tij me faj, në përputhje me parashikimet e Ligjit nr. 32/2021, datë 16.03.2021 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit".

Kjo kontratë sigurimi mbulon përgjegjësinë e të siguruarit ndaj palëve të treta për dëme të ndodhura vetëm në territorin e Republikës së Shqipërisë.

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

- Logaritja e masës së dëmshpërbimit ndaj palëve të treta, për detyrimin që buron nga kjo policë sigurimi, për dëmin e shkaktuar në një aksident, kryhet vetëm mbi bazën e ligjit nr. 32/2021 datë 16.03.2021 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit" dhe Regullores së lëshuar nga Autoriteti në zbatim të ligjit.
- Drejtuesit e mjeteve të përfshirë në një aksident rrugor, për dëmet ndaj pronës në vlerë deri në 30 000 (tridhjetë mijë) lekë, nëse bien dakort duhet të plotësojnë, të nënshkruajnë dhe të shkëmbejnë Raportin European të Aksidenteve, pa patur nevojë që të kenë procesverbalin e konstatimit të shkeljes nga Policia Rrugore. Për dëme ndaj pronës deri në 30 000 (tridhjetë mijë) lekë, vetëm në rastet kur drejtuesit e mjeteve të përfshirë në aksident nuk bien dakord, si dhe për të gjitha dëmet e pronës mbi këtë vlerë duhet të marrin procesverbalin e konstatimit të shkeljes nga Policia Rrugore.

DISPOZITA TË TJERA

- I Siguruarë është i detyruar të njoftojë Rastin e Sigurimit menjëherë por jo më vonë se 72 orë nga momenti i ndodhjes së tij ose nga dita në të cilën ka marrë dijeni, pranë shoqërisë sigurimit.
- Në zbatim të nenit 9, 10 të Ligjit nr. 32/2021, datë 16.03.2021 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit", pas trajtimit dhe marrjes së përgjigjes nga shoqëria e sigurimit/Byroja, pala e dëmtuar që ka pretendime, mund t'i drejtohet gjykatës me padi civile.
- Pala e dëmtuar i drejtohet me kërkesë për dëmshpërblim drejtpërdrejt shoqërisë së saj të sigurimit, në rastin kur shkaktari i aksidentit është i pasiguruar apo i paidentifikuar, mbi çdo dëm të shkaktuar mbi pronën apo shëndetin e tij.
- Afat i parashkrimit të palës së tretë të dëmtuar për kërkimin e dëmshpërbimit nga shoqëria e sigurimit është 2 vjet nga dita e ndodhjes të aksidentit në bazë të nenit 115 shkronja ç) të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.
- Të dhënat personale të mbledhura nëpërmjet kësaj (emri i policës së sigurimit të detyrueshëm) do të përdoren në administrimin e kontratës së sigurimit, për dhënen e shërbimeve ndaj të siguruarit dhe përfituesit, përfshirë trajtimin e dëmit, në zbatim të ligjit nr.32/2021, datë 16.03.2021 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit". Shoqëria e sigurimit (emri i shoqërisë) realizon transferimin e të dhënavë personale tek të tretë për qëllime të sigurimit apo biznesit sipas specifikimeve të ligjit. Në lidhje me të dhënat personale të mbledhura dhe përpunimin e tyre, klienti ka të drejtë të ushtrojë të drejtë e aksesit dhe të drejtat e tjera të parashikuara në ligjin nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënavë personale" (i ndryshuar).

Verifikoni policën tuaj të sigurimit kufitar në Registri Elektronik Online i Shitjeve të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik në faqen web të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare www.amf.gov.al ose duke kontaktuar në konsumatori@amf.gov.al.

GENERAL CONDITIONS

OBJECT OF INSURANCE

The object of this contract is the liability insurance of the driver of the motor vehicle, who enters the territory of the Republic of Albania with a vehicle registered abroad, for the damages that such driver may cause to third parties by the use of such vehicle, as a result of his culpable acts or omissions, in accordance with the provisions of the Law No. 32/2021, dated 16.03.2021 "On compulsory insurance in the transport sector". This insurance contract covers liability of insured against third parties for the damages occurring only in the territory of Republic of Albania.

GENERAL PROVISIONS

- The calculation of the amount of compensation to third parties, on the obligation arising from this insurance policy, for the damages caused in an accident, shall be carried out only pursuant to Law No. 32/2021, dated 16.03.2021 "On compulsory insurance in the transport sector" and regulations issued by the Authority in accordance with this law.
- If the drivers of the vehicles involved in a road accident agree the property damages in the amount of up to ALL 30.000 (thirty thousand) they must fill in, sign and exchange between them the European Accident Report, without the need to have the report of violation findings by the Road Police. Only in cases when the drivers of the vehicles involved in an accident do not agree, for property damages up to ALL 30.000 (thirty thousand), as well as for all property damages above this amount, the drivers must obtain the report of violation findings by the Road Police.

OTHER PROVISIONS

- The insured is obliged to report the insurance case to the insurance company immediately but no later than 72 hours from the moment of the accident or from the day he was informed.
- Pursuant to Article 9 and 10 of Law No. 32/2021, dated 16.03.2021 "On the compulsory insurance in the transport sector" the injured party can file a civil lawsuit in the court, in case of claims after treatment and after receiving a reply from the insurance company/Bureau.
- The injured party addresses directly with a claim for compensation to its insurance company, in case the driver who has caused the accident is uninsured or unidentified, on any property damages or bodily injuries.
- The limitation period of the injured third party for a claim for compensation by the insurance company is 2 years from the day of the accident under Article 115 item ç) of the Civil Code of the Republic of Albania.
- Personal data collected through this contract (*name of compulsory insurance policy*) shall be used for the administration of the insurance contract, for the provision of services to the insured and beneficiaries, including claims handling in accordance with Law No. 32/2021, dated 16.03.2021, "On Compulsory insurance in the transport sector". The insurance company (name of the company) transfers personal data to third parties for insurance or business purposes under the specifications of the Law. In relation to personal data collected and their processing, the client has rights to access and other rights provided by Law No. 9887, dated 10.03.2008 "On Personal Data Protection", as amended.

Check your Border Insurance Policy in the Electronic Register of Compulsory Motor Insurance Sales on the website of the Albanian Financial Supervision Authority (AFSA) www.amf.gov.al or contact consumer@amf.gov.al